



UDHËZIM PËR KONKURIM

Ky dokument u dedikohet organizatave lokale dhe grupeve joformale të cilat dëshirojnë të paraqiten për financim nga BCIF. Në të janë të paraqitur qëllimet e programit të Bashkësive aktive të BCIF-it dhe janë dhënë udhëzimet e konkurimit për donacione, me sqarime se kush, si dhe kur mund të paraqitet. Gjithashtu në këtë dokument sqarohet edhe mënyra se si i shqyrtojmë dhe marrim vendimet për projektet tuaja.

Ju lutemi që me kujdes ta lexoni tërë dokumentin sepse mund t'ju ndihmoj që sa më mirë të përgatisni propozimet tuaja. Nëse keni nevojë për informata shtesë, mund t'i lajmërohemi zyrës së BCIF-it.

1. Qëllimi i mbështetjes (financimit)

Qëllimi kryesor i programit të BCIF-it për Bashkësitë aktive është avancimi dhe zhvillimi i komuniteteve lokale në Serbi, përmes përkrahjes financiare të iniciativave që inkuadrojnë qytetarët në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta në bashkësitë e veta dhe që në mënyrë sa më të mirë ti shfrytëzojnë resurset lokale dhe të promovojnë bashkëpunim me sektorë të ndryshëm.

Qëllimet specifike të programit janë:

- 1) Përkrahja e gatishmërisë dhe aftësisë së njerëzve që t'i vërejnë dhe t'i veçojnë problemet në bashkësi dhe të menojnë mënyrën për zgjidhjen e tyre.
- 2) Nxitja e kreativitetit dhe efikasitetit në zgjidhjen e problemeve me të cilët ballafaqohen bashkësitë në SMZ
- 3) Nxitja e njohjes dhe shfrytëzimit të resurseve/potencialeve lokale (me resurse nënkuptojmë jo vetëm paratë por edhe dijen dhe shkathtësinë e njerëzve, gatishmërinë për të investuar para, mall, punë, kohë, ide, vullnet të mirë, veçori të ndryshme natyrore dhe sociale të mjedisit).

2. Cilat iniciativa mund të mbështeten në kuadër të këtij programi?

Ky program nuk ven kufizime në zgjedhjen e fushave dhe temave. Organizatat/grupet ftohen që vet t'i caktojnë prioritetet të cilat i preokupojnë qytetarët në komunitetet e tyre, të ofrojnë mundësi/ propozime të cilat do të nxisin zgjidhjen e problemeve e me këtë t'i kontribuojnë mirëqenies së tërë komunitetit.

Për përfitimin e donacionit duhet të plotësohen tre kritere themelore:

1. Iniciativa juaj duhet të jetë e lidhur me komunitetin lokal, që do të thotë se duhet të jetë e planifikuar dhe e udhëhequr nga njerëzit që jetojnë në një territor të caktuar (qytet, fshat, komunë, bashkësi lokale, si dhe lagja apo një pjesë e qytetit).
2. Është e rëndësishme të ekzistojë pjesëmarrje aktive e njerëzve në iniciativën tuaj. Kjo nënkupton që ajo inkurajon bashkësinë e gjerë në njohjen dhe zgjidhjen e problemeve dhe kështu përfshin (mobilizon) një grup të madh njerëzish e jo vetëm anëtarët e organizatës suaj ose përfituesit/ shfrytëzuesit direkt të projektit. Gjatë planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve duhet të inkuadroni edhe qytetarët, si dhe përfaqësuesit e institucioneve, organizatave, mediave, donatorëve (sponsorëve) nga bashkësia të cilët nuk janë të prekur direkt nga problemi, por që mund të kenë ndikim në zgjidhjen e tij.

(p.sh. nëse dëshironi të zgjidhni një problem të fëmijëve në bashkësinë tuaj, duhet të përfshini edhe personat që nuk janë fëmijë ose prindër. Nëse dëshironi të zgjidhni një problem të një pakice etnike, duhet të përfshini personat që nuk i takojnë ati grupi).

3. Është e nevojshme që iniciativa e juaj të ketë potencial për t'i sjell përfitim të gjerë komunitetit lokal. Sipas mendimit tonë, përfitimi i gjerë arrihet nëse iniciativa e juaj përfshin një apo më shumë nga këto elemente:

- mobilizon dhe inkurajon njerëzit që të bëhen pjesëmarrës aktiv (në vend të shfrytëzuesve pasiv) në avancimin e komunitetit të tyre lokal, sidomos në procesin e vendimmarrjes.
- krijon raporte të reja në bashkësi midis njerëzve/grupeve të cilët pa këtë iniciativë nuk do të lidheshin.
- sjell ndryshime pozitive në bashkësi të cilat do të zgjasin ose do të inspirojnë ndryshime të reja.
- vendos modele dhe shembuj të rinj të përvojave pozitive në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Ju rekomandojmë që në projektin tuaj të parashihni edhe punën vullnetare, donacionet e subjekteve afariste si dhe bashkëpunimin me faktorë tjerë të rëndësishëm në bashkësi.

3. Vlera e donacionit

Vlera maksimale është 350 000 din.

4. Kush mund të konkurojë

Për këtë program mund të konkurojnë organizatat/grupet që janë:

- a) jofitimprurëse
- b) të themeluara në komunitetin lokal dhe të udhëhequra nga njerëzit e atij komuniteti
- c) nga Serbia

Nuk është e domosdoshme që grupi juaj të jetë i regjistruar që të mund të konkurroni, pasi BCIF mbështet edhe grupet joformale të qytetarëve.

Organizatata nacionale të vendosura jashtë bashkësisë me të cilën lidhet projekti, organizatat ndërkombëtare, institucionet shtetërore dhe iniciativat profitabile, nuk përputhen në kushtet e këtij konkursi dhe nuk mund të paraqiten.

Informata të rëndësishme

- Organizata / grupi duhet të paraqes aplikimin e vet. Nëse një organizatë tjetër aplikon në emër të organizatës tuaj, ajo nuk do të shqyrtohet.

- Në rast se paraqitni një projekt në bashkëpunim me një organizatë tjetër, duhet të theksoni se cila është "organizata udhëheqëse", apo bartëse e projektit.
- Nëse disa organizata / grupe dërgojnë projekte krejtësisht të njëjta, të gjithë ato aplikime do të tërhiqen nga konkurimi.
- në një afat konkurimi, organizata / grupi mund të paraqitet vetëm me një projekt propozim

5. Kriteret për përfitimin e donacionit

Gjatë shqyrtimit të aplikimit tuaj, përveç tre kriterëve themelore të përshkruara më lart, do të vlerësohen edhe sqarimet e qarta që kanë të bëjnë me:

- Rëndësia e projektit për komunitetin lokal në fjalë (dmth. se sa zgjidhja e problemit që keni paraqitur iu përgjigjet nevojave konkrete të atij komuniteti)
- Niveli dhe metodologjia e përfshirjes së qytetarëve (dmth. në ç'masë dhe si, njerëzit nga bashkësia e juaj do të përfshihen në aktivitetet e projektit).
- Përshtatja e zgjidhjeve dhe metodave të propozuara, problemit të parashtruar (dmth. se sa qasja dhe metodat që keni zgjedhur mund t'i kontribuojnë zgjidhjes së suksesshme të problemit)
- Përfitimi që bashkësia do të ketë nga projekti (dmth. në ç'masë realizimi i projektit tuaj do t'i kontribuoj mirëqenies së komunitetit të gjerë lokal)

si dhe atë se, projekti juaj a do:

- të ketë plan real që mund të ekzekutohet
- të ketë ndërlikime të qarta të qëllimeve
- të propozoj buxhet real që përputhet me aktivitetet

ÇKA NUK FINANCON BCIF-i

- Udhëtimet, studimet, pjesëmarrjet individuale ose veprimtaritë e ngjashme
- Nismat që sjellin përfitim dhe projektet që sjellin të ardhura
- Projektet hulumtuuese
- Aktivitetet e partive politike, organizatave, grupeve
- Organizatat dhe institucionet qeveritare (përfshirë edhe shkollat, kopshtet, bashkësitë lokale, etj.)
- Organizatat ose grupet që nxisin dhe promovojnë dhunë dhe jotolerancë
- Blerjen e pajisjeve mjekësore ose shërbimeve mjekësore
- Vetëm trajnime, seminare ose rrjetëzimin e OJQ-ve
- Shkollat e kompjuterëve dhe të gjuhëve të huaja
- Botimin e revistave, librave dhe punimin e web-sajteve si një aktivitet
- Projektet ndërtimore ose investuese, përveç punimeve fare të vogla ndërtimore të cilat do t'i ndihmonin bashkësisë të inkuadrohet në iniciativa të ndryshme
- Pajisjet (siç janë kompjuterët, faksset, aparatet për fotokopjim si dhe pajisjet tjera kancelarike dhe mjetet themelore për punë), përveç në raste të veçanta kur pajisjet janë të domosdoshme për realizimin e aktiviteteve dhe që garanton qëndrueshmëri të projektit.

- Shpenzimet e akomodimit
- Projektet që realizohen në nivel regjional dhe ndërkomunal,
- Organizatat dhe grupet që nuk janë Serbia

6. Sa herë mund të konkuroni dhe të merrni donacion?

- Në konkursin e BCIF-it mund të paraqiteni disa herë, me projekte të ndryshme
- Nëse projekti juaj është refuzuar dy herë dhe në të nuk ka ndryshime të dukshme, herën e tretë automatikisht do tërhiqet nga procedura.
- Në qoftë se keni përfituar donacion, mund të paraqiteni përsëri vetëm pasi të keni dorëzuar raportin përshkrues dhe financiar dhe ai të jetë pranuar nga zyra e BCIF-it.

BCIF-i nuk preferon të përkrah projekte të cilët janë vazhdimësi e aktiviteteve të mëparshme dhe radhë mbështet të njëjtën organizatë më shumë se dy herë.

7. Procedura e prurjes së vendimeve për donacione

Vendimet për financimin e projekteve të paraqitura bihen në këtë mënyrë:

1. Staf i BCIF-it kontrollon të gjitha aplikimet duke vërtetuar se a përputhen në kriteret themelore të konkursit. Të gjitha aplikimet që janë në përputhje me kriteret themelore të konkursit i dërgohen këshilltarit të BCIF-it për regjionin nga cili ka ardhur aplikimi.

2. Këshilltari kontakton organizatën/grupin e cila ka aplikuar dhe jep rekomandim për projektin, bazuar në intervistën (bisedën) me përfaqësuesit e organizatës dhe në bazë të projektit të paraqitur.

3. Aplikimet dhe rekomandimet i kontrollon Këshilli i BCIF-it për donacione, i cili i propozon Bordit të BCIF-it një numër të caktuar aplikimesh

4. Anëtarët e Bordit kontrollojnë propozimet e Këshillit për donacione dhe bien vendimin se cilat iniciativa do të përkrahen.

8. Afati i fundit për dërgimin e aplikimeve

Aplikimet për donacione i pranojmë gjatë gjithë vitit. Pasi të pranojmë aplikimin tuaj, ju informojmë për datën kur mund të prisni përgjigje. Vendimet për donacione bihen 5 herë në vit, ndërsa informacionet për këto termine mund t'i gjeni në web-sajtin e BCIF-it. Procesi i marrjes së vendimeve zgjat dy deri në tre muaj. Të gjitha organizatat/grupet që kanë aplikuar do të informohen për rezultatet, pa marrë parasysh a iu ka kaluar projekti apo jo.

9. SI TË APLIKONI

Që të konkuroni te BCIF-i mjafton të plotësoni fletëparaqitjen dhe ta dërgoni atë.

Fletëparaqitjen mund

- 1) ta merrni nga web-sajti ynë www.bcif.org
- 2) ta fitoni me e-mail ose postë nga zyra jonë, me kërkesën tuaj
- 3) ta kërkonte nga Qendrat regjionale për zhvillimin e sektorit joqeveritar, respektivisht nga resurs-qendrat tjera për OJQ në Serbi

Fletëparaqitjen mund ta plotësoni në gjuhën serbe, shqipe, rome dhe hungareze. Gjuha që do të përdorni nuk do të ndikojë në vendimin për ndarjen e donacioneve. Nëse ju duhet ndihmë për plotësimin e formularëve drejtohuni zyrës tonë.

Kur ta plotësoni fletëparaqitjen dërgojeni me e-mail në adresën:

prijave@bcif.org

Nëse nuk keni mundësi që ta dërgoni në versionin elektronik,

- dërgojeni të shtypur (printuar) në adresën:

BCIF
Majke Jevrosime 19/I
11000 Beograd

- dërgojeni fletëparaqitjen me faks në :
011/3288 723

me shënimin: prijavni formular za program Aktivnih zajednica.

Nëse ju ndahet donacion

Në rast kur ju fitoni donacion, mjetet do të paguhen në xhiro-llogarinë e organizatës pas nënshkrimit të Kontratës për donacion, të cilin e përgatitë Zyra e BCIF-it. Aktivitetet në projekt mund të fillojnë vetëm pasi të jetë kryer kjo procedurë. Shpenzimet e bëra më herët nuk do të mbulohen nga ky donacion.